



## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-536-2013 dt. 28 qershor 2013 për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë "Hydro - Line" SH.P.K., në Lumin Bistrica, HC Albaniku 1, me kapacitet të instaluar prej 6.8 MW, në lokacionin "Vllahi", ZK Vllahi, komuna e Mitrovicës, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për HC Albaniku 1, me kapacitet të instaluar prej 6.8 MW, në lokacionin "Vllahi", ZK Vllahi, të datës 03.02.2015 të shoqërisë "Hydro - Line" SH.P.K., me adresë: rruga "Mbretëresha Teutë", p.n. -Mitrovicë, Republika e Kosovës,

### në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Hydro - Line" SH.P.K., dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Albaniku 1, me kapacitet të instaluar prej 6.8 MW, në lokacionin "Vllahi", ZK Vllahi, komuna e Mitrovicës.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.

## A r s y e t i m


- o ZRRE me datë 03.02.2015 nga shoqëria "Hydro - Line" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Albaniku 1, me kapacitet të instaluar prej 6.8 MW, në lokacionin "Vllahi", ZK Vllahi, komuna e Mitrovicës.





- o Bordi i ZRRE-së me datë dt. 28 qershor 2013, shoqërisë “Hydro - Line” SH.P.K., i ka lëshuar Vendimin V-536-2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
  - o ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-536-2013 dt. 28 qershor 2013 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën i është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, shoqërisë “Hydro - Line” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Merita Kostari, anëtare

  
Kreñar Bujupi, anëtar